



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOV
QENDRA PER SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRADINA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 06.08.2025

Sh. 01 Nr. 21269
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 06/08
Br. str. Datum: 2025
KAMENICA

Në bazë të nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit me nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe neni 12 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2025 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin të Vendimit Bazë me nr. Sh.01.Nr.13588

1. **NDRYSHOHET** Vendimi bazë me numër Sh.01.nr.13588 i datës 03.06.2025 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.

1.1. Në paragrafin (2.1) dhe (2.2) të vendimit bazë të cilat kanë të bëjnë me parcelat sipas çertifikatës së pronësisë P-71107041-01336-1 si dhe parcela me numër P-71107041-01338-0 **fshihet** nga vendimi bazë me numër Sh.01 Nr. 13588, ndërsa

1.3 Pjesa tjetër e vendimit bazë mbetet e pandryshuar.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit bazë me nr. Sh. 01 nr. 13588 i dt. 03.06.2025
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i'u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve. Shërbimit të Kuvendit, MAPL-së, QSHQ-Arkivit

Kryesnesi i Kuvendit Komunal

Erëdon Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më:06.08.2025

Në bazë të nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), neni 17 paragrafi 1 shkronja b), neni 40, shkronja 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1 dhe neni 6, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1, lidhur me nenin 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenin 11 dhe nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, nga MMPHI për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033”, si dhe nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja b), nenin 38, paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.07.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

Neni 1

MIRATOHET “Plani Zhvillimor Komunal” për Komunën e Kamenicës për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2025–2033” (në tekstin e mëtejme PZHK), si një dokument i planifikimit hapësinor multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej ($S = 4,166,323.74 \text{ m}^2$), $S = 416.624 \text{ km}^2$.

Neni 2

- 2.1. “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës.
- 2.2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Kamenicës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2023, dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, dhe i miratuar me Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë

05.06.2025, për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

2.3. “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Raportin e Shqyrtimit Publik, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi. Të gjitha këto janë të përkthyer në gjuhën serbe.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Kamenicës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr. 10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në web-faqen zyrtare të komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. protokolli Sh.01 nr. 06-15525, datë 08.05.2014, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2013–2023+.

***Vendimi t’i dërgohet:** Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe QSHQ- arkivit.*

Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Elidon Kastrati



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
CENTRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADAN

Sh. 01 Nr. 21280
U. Br.
Nr. i faq. 02 Data: 06/08/2025
Br. str. KAMENICE/A 2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më:06.08.2025

Bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja d) neni 14, neni 17 pika c) dhe neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenin 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.07.2025, miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Miratohet Vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik për pronat e paluajtshme, si në vijim:
 - 1.1 Prona e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 8163 m², sipas certifikatës pronësore P-71107058-01795-0 të datës 14.07.2025, në Zonën Kadastrale Hodonoc në vendin e quajtur "Stara Kuqa" në pronësi të P.SH.Koperativa Bujqësore.
 - 1.2 Prona e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 7167 m², sipas certifikatës pronësore P-71107062-00008-0 të datës 14.07.2025, në Zonën Kadastrale Petroc në vendin e quajtur "Gabriçe" në pronësi të P.SH.Koperativa Bujqësore Zhivko Vasiq.
 - 1.3 Prona e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 661 m², sipas certifikatës pronësore P-71107062-00007-0 të datës 14.07.2025, në Zonën Kadastrale Petroc në vendin e quajtur "Gabriçe" në pronësi të P.SH.Koperativa Bujqësore Zhivko Vasiq.
2. Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria

Ar sy e t i m

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) përmes shkresës së saj me nr. protokolli 39006 të dt. 23.06.2025, ka njoftuar Komunën e Kamenicës për përfshirjen e 74-të, të aseteve në procesin e shitjes përmes likuidimit. Pas pranimit të këtij njoftimi, Kryetari i Komunës së Kamenicës iu ka adresuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përmes shkresës me numër protokolli Sh. 02 Nr. 17914 i dt. 16.07.2025, me të cilën shkresë ka shprehur interesim institucional për përjashtimin nga shitja të këtyre aseteve ngase të njëjtat ndodhen brenda territorit të komunës sonë dhe kanë rëndësi strategjike për zhvillimin lokal, andaj është kërkuar përjashtimi i këtyre aseteve-ngastrave kadastrale P-71107058-01795-0, P-71107062-00008-0 si dhe P-71107062-00007-0, me qëllim të shpalljes me interes të përgjithshëm publik.

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyra e Informimit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së, -QSHQ-së -Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
CENTRA PER SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 06.08.2025

Sh. 01 Nr. 21281
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 06/08
Br. str. Datum: 2025
KAMENICA

Në bazë të nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit me nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe neni 12 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2025 miraton këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT SH.01.Nr.13586 TË DATËS 03.06.2025 PËR MIRATIM TË VENDIMIT PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR “SOLAR GREEN ENERGY SH.P.K”, ME PROCEDURË TË NEGOCIMIT TË OFERTËS

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi SH.01.Nr. 13586 të datës 03.06.2025 për miratim të vendimit për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Solar Green Energy Sh.P.K”, me procedurë të negocimit të ofertës.
2. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të cekur në pikën (1) një të këtij vendimi, MAPL me shkresën Nr 020-369/22 të datës 21.07.2025, konstaton se akti në fjalë duhet të rishqyrtohet nga Kuvendin Komunal në Kamenicë dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, meqë vendimi nuk është harmonizuar brenda afatit ligjor, vendimi me nr. Sh.01 nr. 13586 shfuqizohet.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës dhe drejtorit përkatëse.
4. Bashkangjitur e gjeni Kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë me numër Nr 020-369/22 të datës 03.06.2025.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.



Liridon KASTRATI
Kryetari i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 06.08.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), si dhe në mbështetje të Ligjit me nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 i Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.07.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike

1. Me këtë vendim miratohet caktimi i lokacioni për vendosjen e trafos elektrike.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71107063-00977-1, në zonën kadastrale Poliqkë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 187246 m², e evidentuar në posedim të Kuvendit Komunal Kamenicë.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, të ndahen 9m² (nëntë metra katror), për vendosjen e trafos elektrike, poashtu, është dhënë pëlqimi parimor nga KEDS Nr.1969 e datës 19.02.2025 për rregullim të dokumentacionit teknik për pëlqim elektroenergjetik.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Kamenicës dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-s dhe QSHQ- arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU
Sh. 01 Nr. 21285
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 06/08
Br. str. Datum: 2025
KAMENICE

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 06.08.2025

Në bazë të nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit me nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe neni 12 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2025 miraton këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT SH.01.Nr.13599 TË DATËS 04.06.2025 PËR MIRATIM TË VENDIMIT PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PËR “VETON KALLABA B.I”, ME PROCEDURË TË NEGOCIMIT TË OFERTËS

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi SH.01.Nr. 13599 të datës 04.06.2025 për miratim të vendimit për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Veton Kallaba B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës.
2. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të cekur në pikën (1) një të këtij vendimi, MAPL me shkresën Nr 020-369/21 të datës 21.07.2025, konstaton se akti në fjalë duhet të rishqyrtohet nga Kuvendin Komunal në Kamenicë dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, meqë vendimi nuk është harmonizuar brenda afatit ligjor, vendimi me nr. Sh.01 nr. 13599 shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorit përkatëse.
4. Bashkangjitur e gjeni Kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë me numër Nr 020-369/21 të datës 21.07.2025.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.



Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosovë
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
CENTRALE SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. 01
Br. 21967
Nr. i faq. 01
Data: 12/08
Datum: 2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më:06.08.2025

Bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 2 shkronja d), nenin 17 shkronja h) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenin 38, paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me kërkesën Sh.05.Nr.18786, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.07.2025, miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës

1. Formohet Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Ramadan Guda – (Zyrtar në DKA);
 - 2.2. Selami Klaiqi – (Drejtore në Gjimnazin "Ismail Qemali", Kamenicë); dhe
 - 2.3. _____ – (MASHTI).
3. Komisioni përzgjedhës obligohet që punët t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i Komisionit zgjat deri në nxjerrjen e vendimit/vendimeve përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatit/kandidatëve në pozitën/pozitat e shpallura me konkurs.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të kuvendit dhe pas publikimit në uebfaqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit, Zyrës së përkthimeve, MAPL-së, QSHQ- Arkivit.

